

Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri


Prill 2022

Tiranë, më 26 Maj 2022: Hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar, në muajin Prill 2022, janë 832.920. Krahasuar me Prill 2021, ky tregues rezulton me një rritje 78,6 %. Në Prill 2022, numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 402.051. Krahasuar me Prill 2021, ky numër është rritur me 66,8 % (tab.1).

Hyrjet e shtetasve

Gjatë katërmujorit të parë 2022, nga vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Greqia ka pasur rritjen më të madhe me 6 herë, ndërsa Kosova ka pasur rënien më të ndjeshme me 13,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 (tab.2).

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Për publikim 26/05/2022

Daljet e shtetasve

Daljet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Prill 2022, janë 834.528 duke shënuar një rritje me 85,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Daljet e shtetasve shqiptarë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Prill 2022 janë 449.294. Krahasuar me Prill 2021, ky numër është rritur me 2 herë. Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Prill 2022, janë 385.234. Krahasuar me Prill 2021, ky numër është rritur me 75,5 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i Shqipërisë gjatë katër muajve të parë të 2022, është 1.502.984 duke u rritur 52,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë (tab1).

Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj

Periudha	Prill 2021	Prill 2022	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Prill 2021	Janar-Prill 2022	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje gjithsej	466.283	832.920	78,6	1.627.147	2.378.904	46,2
Shqiptarë	225.268	430.869	91,3	872.288	1.305.643	49,7
Të Huaj	241.015	402.051	66,8	754.859	1.073.261	42,2
Dalje gjithsej	449.930	834.528	85,5	1.685.661	2.624.842	55,7
Shqiptarë	230.468	449.294	94,9	986.873	1.502.984	52,3
Të Huaj	219.462	385.234	75,5	698.788	1.121.858	60,5

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj

Shtetet	Prill 2021	Prill 2022	Janar-Prill 2021	Janar-Prill 2022
Kosovë	136.022	107.436	381.389	329.477
Maqedoni	27.207	54.638	120.386	151.701
Greqi	5.750	49.539	20.350	123.027
Itali	13.005	40.104	43.601	113.762
Angli	1.516	13.230	5.801	31.868
Mali i zi	26.766	42.595	89.760	118.540
Poloni	904	2.360	1.706	4.488
SHBA	3.080	7.443	8.845	18.897
Spanjë	343	2.337	858	4.555
Gjermani	3.311	14.822	10.529	27.784
Zvicër	2.217	6.125	6.510	10.818
Të tjera	20.894	61.422	65.124	138.344
Gjithsej	241.015	402.051	754.859	1.073.261

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Periudha	Prill 2021	Prill 2022	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Prill 2021	Janar-Prill 2022	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje Shtetas të Huaj	241.015	402.051	66,8	754.859	1.073.261	42,2
I. Personale	232.560	393.149	69,1	722.421	1.040.326	44,0
1. Pushime, vizitë tek të afërm, etj.	219.200	370.716	69,1	685.546	991.368	44,6
2. Trajtime shëndetësorë	105	32	-69,5	531	417	-21,5
3. Qëllime fetare	40	71	77,5	125	152	21,6
4. Udhëtarë transit	13.215	22.330	69,0	36.219	48.389	33,6
II. Biznes dhe profesionale	8.455	8.902	5,3	32.438	32.935	1,5

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Tab. 4 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit

Periudha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Prill 2021	50,186	20,388	395,709	51,172	15,426	383,332
Prill 2022	189,915	31,189	611,816	192,240	28,408	613,880
Ndryshimi vjetor (%)	278,4	53,0	54,6	275,7	84,2	60,1
Janar- Prill 2021	163.670	70.139	1.393.338	178.103	68.620	1.438.938
Janar- Prill 2022	551.460	90.133	1.737.311	591.244	103.416	1.930.182
Ndryshimi vjetor (%)	236,9	28,5	24,7	232,0	50,7	34,1

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Metodologjia

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

Përkufizime

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet: Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.

Vizitor: Për qëllime të statistikave të turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

Qëllime personale të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm, trajtim shëndetësor etj.;
2. Trajtim shëndetësor;
3. Qëllime fetare;
4. Udhëtarë tranzit.

Kategoria e biznesit që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi të vazhdueshëm. Për më shumë referohu: [http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/Politika e Revizionimit Statistikor](http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/Politika_e_Revizionimit_Statistikor).

Diferencat statistikore midis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:

- Ligjit nr.71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”, neni 17 “Lehtësimi i verifikimeve Kufitare”, ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuar, në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistrojnë shtetasit në hyrje;
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtarë, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje;
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e Shqiptarëve të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarohen shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.